



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E MITROVICËS
Opština Mitrovica - Municipality of Mitrovica



Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia

Nr. prot. _____

MIRATOJ: Drejtori i DSE-së
Bahar MAXHUNI

Plani i Punës

Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia dhe Njësisë Profesionale për Zjarrfikëje dhe Shpëtim

për vitin 2025

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO	
KOMUNA E MITROVICËS - OPŠTINA MITROVICA	
Nr. i dokumentit:	02 240301-0013622/25
Drejtori:	09.03.2025
Shefi:	Mirza Ibro - Mitrovica

27.12.2024

MITROVICË

Në bazë të Ligjit për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera Nr. 04/-L-027, Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 02/L-41, Ligji për Zjarrfikës dhe Shpëtim, Ligji për Vetëqeverisjes lokale Nr. 03/L-040, aktet tjera nënligjore, aktin e Kuvendit Komunal të Mitrovicës për themelimin e Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia dhe fushë veprimtarisë së tij të punës-rregulloria komunale 01/2022 për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësit e Administratës Komunale, neni 64, të veprimtarisë së njësive organizative (Sektori i Parandalimit dhe Gatshmërisë, Sektori i Reagimit dhe Rimëkëmbjes, sektori për Planifikim, Plane dhe Programme dhe Njësia Profesionale për Zjarrfikëje dhe Shpëtim), Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia harton:

PLAN PROGRAMIN E PUNËS PËR VITIN 2025

HYRJE

Plan Programi i punës së Drejtorisë për Siguri dhe Emergjencia është shtyllë kryesore e veprimtarisë së tri Sektoreve të shkoqitura dhe të miratuara nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjencia, të cilat kanë të bëjnë me vendosjen e rregullave dhe të organizimit për marrjen e masave preventive, për mbrojtje dhe shpëtim të njerëzve, të shtazëve, të pasurisë, të trashëgimisë kulturore dhe të ambientit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera si dhe në organizimin respektivisht në përcaktimin e të drejtave dhe detyrave të qytetarëve, institucioneve, ndërmarrjeve, ndërmarrjeve me interes publik, gjithë personat juridik, gjithëherë të bazuara me Ligje, aktet nënligjore dhe me standardet evropiane, që rregullojnë këtë lami, duke respektuar të drejtat e çdo njërit që ka nevojë për mbrojtje dhe shpëtim pa kurrfarë diskriminimi dhe pa mare parasysh: racën, gjininë, bindjen fetare ose përkatësin kombëtare.

Gjatë hartimit të plan programit të punës, objektivat themelore të kësaj Drejtorie do të jenë:

Përcaktimi i rregullave bazë dhe organizimin për reagim ndaj rasteve emergjente/krizave dhe koordinimin e marrëdhënieve në raport me nivelin lokal dhe në raport me nivelin rajonal dhe qendror.

Përcaktimi dhe ngritja e masave preventive në vendet e vlersuar të rrezikshme nga FNFT, në ndërtimin e mureve, pengesav dhe ndërtimin e skarpateve nëvitiimin e rrezikut për popullatën e komunës së Mitrovicës dhe më gjerë.

Përcaktimin e të drejtave dhe detyrave të qytetarëve, ku parashihet që çdo qytetar i moshës 18-65, gjegjësisht 55 vjeç për femra, janë obligues i forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Azhurimi i Vlerësimit të Rrezikshmëris nga FNFT dhe përpilimi i skenareve në bazë të vlerësimit të rrezikshmëris.

Ngritja e nivelit profesional të punëtorëve të Drejtorisë, përcjellja me rregull e të arriturve në lëmin e Sigurisë dhe Emergjencave dhe inkorporimi i këtyre diturive në tejkallimin e dukurive me rrezik për jetën dhe pasurin e qytetarëve në territorin e Komunës së Mitrovicës dhe më gjerë.

Menaxhimi adekuat dhe real i detyrave dhe obligimeve në tejkallimin e krizave evidente dhe të jashtëzakonshme në qytet me rrethinë dhe sipas nevojave dhe kërkesës edhe më gjerë.

Hartimi i Planeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rast të fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësisë tjera.

Formimi i Shtabit Emergjent Statik, Shtabeve Emergjente lëvizëse të Mbrojtjes dhe të Shpëtimit në ato vende ku ka mundësi të formimit dhe të funksionimit në terene.

Planifikimi, koordinimi dhe menaxhimin e Sigurisë dhe Emergjencave si në nivelin Komunal ashtu edhe në atë të Bashkësisë Lokale dhe më gjerë.

Rrëfja e nivelit funksional për Alarmim dhe Koordinim, me qëllim të informimit të publikut në mënyrë efektive dhe me kohë lidhur me fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera dhe të sigurimit të informatave të sakta në kohë për të gjitha shërbimet emergjente të rëndësishme (FSK-ën, PK-ës, shërbimin emergjent shëndetësorë, shërbimet humanitare-banorë vendore dhe ndërkombëtare, agjenci dhe shërbimet të specializuara në fushën e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera).

Planifikimi real i mjeteve financiare në realizimin e projekteve dhe objektivave tona mbështetet në mundësitë financiare buxhetore.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve me FSK-ën, PK-ën, EULEX-un, KFOR-in, Agjencionin e Menaxhimit të Emergjencave në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Kosovës, Kuvendin Komunal, Bordin e Drejtorëve, Drejtoritë relevante, Bashkësitë Lokale, Ndërmarrjet Publike, Kompanitë e mëdha dhe të mesme e etj.

Aftësimet dhe trajnimet profesionale të zyrtarëve të Drejtorisë, Zjarrfikësve dhe subjekteve tjera komunale të planifikuara me plan programet e njëzive organizative të Drejtorisë nëpër lëmit e veçanta të veprimt. Organizimi i mëtjejm i Sigurisë dhe Emergjencave, duke i dhënë prioritet Bashkësive Lokale dhe Ndërmarrjeve Publike Komunale, dhe shkëmbimi i përvojave të ndërsjella nëpër subjektet Komunale. Zhvillimi i kadrave dhe materialo-teknik i Shërbimit të Zjarrfikësve, ngritja e shkallës profesionale të njëzisë për veprimet Emergjente, forcimi para se gjithash i bazës teknike me mjetet e duhura përcjellëse. Ndërmarrja e masave mbrojtëse, siç janë: masat hapësimore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike, evakuimi, strehimi, pranimi dhe furnizimi i qytetarëve të rrezikuar, mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike, strehimi si dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore.

Forcimi i mëtejshëm i inspektimeve dhe pjesëmarrja aktive në përgatitjen e subjekteve Komunale për të vepruar në shpëtimin e jetës, dhe të mirave materiale të qytetarëve në përgjithësi, aftësimi i shërbimit Komunal për një siguri fizike adekuate dhe profesionale.

Përcjellja e fazave të organizimit dhe zhvillimit të sistemit të lidhjeve dhe informimit e alarmimit, informimi i qytetarëve dhe përgjegjëse Komunal mbi të dhëna që cenojnë dhe rrezikojnë popullatën dhe të mirat materiale.

Kërkimi i mundësive në hartimin e planeve dhe programeve për stërvitjen e popullatës, shtabeve dhe njësisve të Mbrojtjes dhe Shpëtimit, të besueshmëve, rimisë e etj.

Janë këto objektivat tona themelore dhe më të rëndësishmet por jo edhe të vetmet. Jenni të vetëdijshëm se jashtë kornizave të programit vjetor do të përshihen edhe një mori çështjesh dhe problemesh aktuale për kohën. Sidoqoftë kemi tentuar të jemi sa më konkret dhe objektiv, real dhe konsekuent pikësëpari në tejkalimin e dukurive më akute që e rëndojnë qytetarin dhe Komunën tone. Besojmë se do të kemi përkrahjen e përgjegjësve komunal së pari të Kuvendit, Bordit të Drejtorëve dhe të tjerëve në shpëllimin e problemeve të shumta tek ne.

Së fundi, Programi vjetor i Drejtorisë, obligon njësitë organizative të vetat që të bëjnë planifikimet e tyre programore vjetore, mujore dhe javore, me të cilat do të definoreshin bartësit në hartimin dhe realizimin e tyre konkret. Gjithashtu edhe ekzekutuesit e punëve (bashkëpunëtorët) me program obligohen t'i përmbushin planifikimet e lartpërmendura të aktiviteteve të tyre.

Drejtori i Drejtorisë në pajtim me kompetencat e veta, sipas nevojës dhe kërkesave do të urdhërojë plotësimin e këtij programi me detyra dhe obligime që dalin nga Programi i Kuvendit, Bordit të Drejtorëve, Drejtorive relevante të Komunës, Agjensionit të Menaxhimit Emergjent të Ministrisë të Punëve të Brendshme, MAPL-ës dhe Komitetit

Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim, ai në bazë të nevojave aktuale do të bëjë ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme në plan programin e punës.

Për të gjitha ndryshimet dhe plotësimet të këtij plan programi të punës do të informohet Bordi i Drejtorëve që shqyrton dhe miraton këtë program.

PLANI I PUNËS SË DREJTORISË PËR SIGURI DHE EMERGJENCA-MITROVICË 2024
Dinamika e rrjedhës së punës

Nr.	Emërtimi i detyrave/ aktiviteteve të planifikuara Objektivat	Bartësi i detyrës/ aktiviteteve	Bashkëpunimi me	Koha e realizimit
	1	2	3	4
01	Hartimi i Plan-programit të punës së DSE-së për vitin 2025	DSE	Sektorët e DSE	Janar
02	Përpilimi i raportit vjetor të punës për vitin 2024	DSE	Sektorët e DSE	Janar
03	Ndërmarrja e masave të menjëhershme në ofrimin e ndihmës me rastin e shfaqjes së fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera (elementare dhe aksidenteve).	DSE	Shërbimet Emergjente NJPZSH, SHM, PK-ës, operatorët e kontraktuar dhe të tjerë, FSK-ës, etj	Janar- Dhjetor

Nr.	Emërtimi i detyrave/ aktiviteteve të planifikuara Objektivat	Bartësi i detyrës/ aktiviteteve	Bashkëpunimi me	Koha e realizimit
	1	2	3	4
04	Konstatimi dhe evidentimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe ndërmarrja e masave adekuata për sanimin e gjendjes.	DSE	Drejtoritë tjera	Janar- Dhjetor
05	Planifikimi i masave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera.	DSE		Janar- Dhjetor
06	Azhurnimi i Planeve Operative për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.	DSE	Sektorët e DSE	Janar- Dhjetor
07	Përpunimi i Planit Operativ Emergjent Lokal	DSE	Subjektet Relevante Lokale	Janar- Mars
08	Rishikimi - Vlerësimi i rrezikshmërisë nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	DSE	Subjektet relevante	Janar- Dhjetor
09	Harmonizimi dhe përditësimi i planeve të reagimit emergjent me institucionet, ndërmarrjet dhe organizatat e tjera përkatëse të komunës në fushën e gatishmërisë emergjente.	DSE	Subjektet relevante	Janar- Dhjetor
10	Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë Tjera nga komisioni Lokal	DSE	Kryetari-Drejtoritë tjera	Janar- Dhjetor
11	Formimi-aktivizimi i Qendrës Operative Emergjente Lokale për Mbrojtje dhe Shpëtim nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera, kur e kërkon nevoja.	DSE	Kryetari-DSE	Janar- Dhjetor

Nr.	Emërtimi i detyrave/ aktiviteteve të planifikuara Objektivat	Bartësi i detyrës/ aktiviteteve	Bashkëpunimi me	Koha e realizimit
	1	2	3	4
12	Themelimi i njësie për intervenime të përgjithshme në nivel komune.	DSE		Janar- Dhjetor
13	Përcaktimi i një objekti për Depo dhe angazhimi për krijimin e rezervave materiale për çështje emergjente.	DSE	Subjektet relevante	Janar- Dhjetor
14	Sensibilizimi i popullatës për mbrojtjen personale dhe reciproke për pengimin dhe zvogëlimin e pasojave nga të gjitha fatkeqësitë (natyrore, teknike etj.)	DSE	Përfatësuesit e Bashkësive lokale dhe Shërbimet informuese të shkruara dhe e elektronike	Janar- Dhjetor
15	Organizimi i mbajtjes së ushtrimit më tërmen: Shpëtimi dhe evakuimi i nxënësve dhe personelit të një shkolle fillore, në situatën emergjente nga zjarri dhe tërmeti.	DSE	Drejtoria e Arsimit, Policia e Kosovës, Shërbimi Medical, Personeli i shkollës dhe NJPZSH, Kryqi i Kuq dhe njësit tjera relevante	Maj
16	Koordinimi i punëve rreth dhënies së pëlqimeve në dokumentacion investivo - teknik dhe në lokacion, respektimi i standardeve për raste emergjente, ato nën përgjegjësin e Komunës.	DSE	DSE-Komisionin adekuatë	Janar- Dhjetor
17	Angazhimi-formimi i Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, me vendim të Kryetarit.	Drejtori- DSE	Kryetarin e Komunës, anëtarët e KKS	Janar
18	Evidentimi koordinimi dhe propozimi i punëve dhe aktiviteteve, për parandalim-eliminimin e pikave emergjente të cilat	DSE	DSE dhe Drejtoritë tjera	Janar- Dhjetor

Nr.	Emërtimi i detyrave/ aktiviteteve të planifikuara Objektivat	Bartësi i detyrës/ aktiviteteve	Bashkëpunimi me	Koha e realizimit
	1	2	3	4
	paragesin rrezik në territorin e komunës si pika kritike.			
19	Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve dhe Menaxhimi i strehimoreve.	DSE	DSE dhe Drejtoritë tjera	Janar -Dhjetor
20	Ngritja e nivelit të gatishmërisë emergjente në komunë.	DSE	Drejtoritë dhe institucionet tjera të komunës	Janar- Dhjetor
21	Vetëdijësimi i qytetarëve - nxënësve të shkollave përmes ligjëratave nga lania e mbrojtjes nga zjarri.	DSE	DSE, NJPZSH, Drejtoria e Arsimit,	Prill- Maj
22	Përpilimi i raporteve dhe informatave të ndryshme nga lëmi i Mbrojtjes dhe Shpëtimit.	DSE	Sektorët e DSE	Janar- Dhjetor
23	Planifikimi, evidentimi dhe sistemimi i resurseve njerëzore dhe mjeteve materialo- teknike , për nevoja emergjente	DSE	Institucionet, kompanitë publike dhe private.	Janar- Dhjetor
24	Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve të rregullta në mes të Shërbimeve Emergjente.	DSE	Shërbimet Emergjente mjeksore, kryqi i kuq, NJPZSH, PK-ës, FSK-ës, etj.	Janar- Dhjetor
25	Alarmimi dhe informimi i publikut për rreziqet e mundshme dhe dhënien e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.	DSE	Subjektet komunale, lokale, përfaqësuesit e fshatrave, QOER 112	Janar- Dhjetor
26	Ripërtëritja e licencës për frekuenca të telekomunikimit (nëse nuk është bërë)	DSE	Ministritë e Punëve të Brendshme (MPB)	Janar- Dhjetor

Nr.	Emërtimi i detyrave/ aktiviteteve të planifikuara Objektivat	Bartësi i detyrës/ aktiviteteve	Bashkëpunimi me	Koha e realizimit
	1	2	3	4
27	Sigurimi i Dhomës emergjente (Qendra Operative Emergjente) dhe pajisja e saj me mjete të sofistikuar komunikuese.	DSE		Janar- Dhjetor
28	Mbajtja e evidencës së kërkesave dhe informatave të pranuar dhe shpërndarjes së tyre.	DSE		Janar- Dhjetor
29	Kontrollimi-inspektimi i institucioneve të larta arsimore, shkollave të mesme dhe fillore në komunë në sferën e mbrojtjes nga zjarri.	DSE	Zyrtarët e Preventivës- Inspektorët	Janar- Dhjetor
30	Kontrollimi dhe inspektimi i objekteve tregtare dhe sportive në komunë në sferën e mbrojtjes nga zjarri.	DSE	Zyrtarët e Preventivës- Inspektorët	Maj
31	Kontrollimi i objekteve bujqësore si dhe përcjellja e përgatitjeve të fushatës së korrije-shirjeve në komunë në sferën e mbrojtjes nga zjarri.	DSE	Zyrtarët e Preventivës- Inspektorët	Qershor- Shtator
32	Kontrollimi i objekteve të shtëpisë së shëndetit, ambulancave dhe Spitalit në sferën e mbrojtjes nga zjarri.	DSE	Zyrtarët e Preventivës- Inspektorët	Tetor
33	Planifikimi i pjesëmarrjes së zyrtarëve të DSE-së, në seminare, trajnime dhe punëtori me qëllim të ngritjes së nivelit profesional në realizimin e detyrave.	DSE	AME/MPB dhe të tjerë	Janar- Dhjetor
34	Pranimi dhe regjistrimi i lëndëve, distriboimi dhe arkivimi i tyre përmes internetit dhe njoftimi i palëve me	DSE		Janar- Dhjetor

Nr.	Emërtimi i detyrave/ aktiviteteve të planifikuara Objektivat	Bartësi i detyrës/ aktiviteteve	Bashkëpunimi me	Koha e realizimit
	1	2	3	4
	vendimet e miratuara.			
35	Kontaktet permanente në relacionin DSE dhe AME/MPB të Kosovës	DSE	QOEL-AME/MPB të Kosovës	Janar- Dhjetor
36	Përcjellja dhe evidentimi i pikave të prekura nga përmblyjet dhe maria e masave preventive në minimizimin e pasojave nga kjo dukuri.	DSE	DSE- Operatorët ekonomik të kontraktuar nga komuna.	Janar- Dhjetor
37	Vlersimi i dëmeve nga FNFT në territorin e komunës së Mitrovicës	DSE	Komisioni për vlersim të dëmeve-Kuvendi komunal, Komisioni Qendror për vlersim të dëmeve-AME	Janar- Dhjetor

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
AGJENCIA E MENAXHIMIT EMERGJENT
NJËSIA PROFESIONALE E ZJARRFIKJËR DHR SHPËTIMIT
Mitrovicë

PLANI I PUNËS DHE AKTIVITETEVE I NJPZSH PËR VITIN 2024

Duke u bazuar në Ligjin për Mbrojtje nga zjarri Nr.02/L-41 dhe Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim Nr.04/-L-049 si dhe duke u bazuar në nevojat reale të organizimit dhe veprimit, NJPZSh bie këtë:

PLAN TË PUNËS DHE AKTIVITETEVE PËR VITIN 2025

Hyrje

Plani i punës bëhet me qëllim të pjesëmarrjes së njërive zjarrfikëse në fikjen e zjarrit, shpëtimin e njerzëve dhe pasurisë së rrezikuar nga zjarri dhe shpërthimet, ofrimin e ndihmës teknike në fatkeqësitë dhe situatat e rrezikshme, zbatimin e masave parandaluese të mbrojtjes nga zjarri e tj.

Objektivat e NJPZSh për këtë vit:

- Ngritja e nivelit profesional të pjestarëve të NJPZSh me qëllim të mbrojtjes së jetës dhe pasurisë së rrezikuar të qytetarëve.
- Bashkpunimi dhe koordinimi i punëve me Policinë e Kosovës, FSK-në, KFOR-in, me ndërmarrjet publike e tj.
 - Trajtime të avancuara të pjestarëve të NJPZSh-së
- Furnizimi dhe paisja e NJPZSh me automjete dhe pajisje më të përsosura dhe më të reja për mbrojtje nga zjarri.
 - Bashkëpunimi më i madh me Shërbimet Zjarrfikëse tjera, sidomos me ato të afërta.
- Të bashkëpunohet më tepër me Shogatën Vullnetare të Zjarrfikësve të Mitrovicës, sidomos gjatë sezonit të temperaturave të larta.

Automjetet dhe paisjet zjarri-fikëse:

Njësia Profesionale e Zjarri-fikës dhe Shpëtimit momentalisht disponon me gjashtë automjete zjarri-fikëse, edhe atë dy automjete sulmuese, dy automjete përcjellëse, një autoshtakallë dhe një automjet për zjarre fushore-malore.

Këto automjete janë në gjendje funksionale por disa prej tyre janë vjetruara dhe të amortizuara.

Për efikasitet të punës dhe efekte më të mira në intervenimet zjarri-fikëse NJPZSh duhet që të paiset edhe me këto automjete:

- Automjet komandues
- Automjet përcjellës
- Automjet teknik

Të bëhet zgjerimi i objektit të NJPZSh edhe me katër garazha pasi që automjetet zjarri-fikëse nuk mund të qëndrojnë jashtë gjatë sezonit të dimrit.

Mungesa e energjisë elektrike na shkakton probleme në kryerjen e punëve dhe aktiviteteve tona për arsye se lokacioni ku gjendet objekti i NJPZSh ka reduktime të shpeshta të rrymës.

Për këtë arsye duhet që objekti i NJPZSh të kyqet në rrjet stabil me qëllim të furnizimit të pa ndërprerë me energji elektrike, si dhe objekti të paiset me një gjenerator të rrymës elektrike prej 20 kv.

Trajninet e planifikuara të pjestarëve të NJPZSh në Qendrën për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtri.

- Trajnine të avancuara për zjarri-fikje dhe shpëtim
- Trajnine për zjarre të brendshme.
- Trajnine për ndihmë të parë
- Trajnine për ruajtjen e gjurmëve gjatë shuarjes së zjarrit.
- Trajnimi i menagjimit të vijës së parë.
- Vozitje emergjente.

- Trajnime për aksidente trafikë.
- Trajnime tjera

Në vazhdim është dhënë plani intern i ushtrimeve praktike dhe teorike për vitin 2025

JAVA	USHTRIMET PRAKTIKE DHE MËSIMET TEORIKE
JAVA 1	Paisjet zjarrefikëse, personale dhe të përbashkëta
JAVA 2	Nocioni i djegjes, kushtet e zhvillimit të djegjes
JAVA 3	Klasifikimi i zjarreve
JAVA 4	Ushtrime praktike rutinore
JAVA 5	Shkëmbimi i gazrave të zjarreve të brendshme
JAVA 6	Mënyra e ndërprerjes së zjarrit: me ftohje, ngulfaje me ndriimin e raportit kuantitativ të materies ndezëse dhe oksigjenit
JAVA 7	Proçesi i fikjes së zjarrit me principet e lokalizimit të zjarrit me metodën: paralele, të ndarë, serike, relejë dhe të kombinuar
JAVA 8	Ushtrime praktike me gypa zjarrefikës, me përdorimin e mbledhëses
JAVA 9	Mjetet për fikjen zjarrit: uji , vetit fizike dhe kimike të ujit, mënyra e veprimit të ujit gjatë fikjes
JAVA 10	Mjetet për fikjen e zjarrit: shkuma, llojet e shkumës, origjina si dhe aparatura për përfitim e shkumës
JAVA 11	Ushtrime praktike: përdorimi i ujit dhe shkumës si mjet për fikje
JAVA 12	Mjetet për fikjen e zjarrit: dioksidi i karbonit dhe pluhuri: karakteristikat e tyre dhe mënyra e veprimit gjatë fikjes së zjarrit
JAVA 13	Ushtrime praktike: përdorimi i pluhurit dhe dioksidit të karbonit si mjet për fikje

JAVA 14	Ushtrime praktike me shkallë
JAVA 15	Organizimi i shërbimit zjarrfikës: forma e organizimit të njërive zjarrfikëse dhe mundësia e veprimit taktik të tyre
JAVA 16	Ushtrime praktike: përdorimi i aparateve zjarrfikëse,karakteristiket teknike, miëmbajtja
JAVA 17	Veprimi taktik gjatë intervenimit: pranimi i zjarrit, alarmimi, dalja në vend të ngjarjes,vlerësimi i situatës dhe marrja e vendimit për intervenim
JAVA 18	Automjetet zjarrfikëse: llojet ,destinimi,mënyra e përdorimit, dhe miëmbajtja
JAVA 19	Taktika zjarrfikëse: renditja e forcave dhe paisjeve për intervenim,shpëtimi i njerzve të rrezikuar në zjarre
JAVA 20	Pompat zjarrfikëse: llojet e pompave,destinimi,karakteristikat teknike, përdorimi dhe miëmbajtja
JAVA 21	Ushtrime praktike: puna me pompë motorrike zjarrfikëse
JAVA 22	Taktika zjarrfikëse: renditja dhe veprimi i mbajtësve të fushkaës,hapja dhe demolimi i konstrukcioneve të ndryshme
JAVA 23	Ushtrime praktike: thithja e ujit nga lartësitë më të larta dhe përdorimi i thellëthithësit
JAVA 24	Ushtrime praktike: përdorimi i hidrantit për furnizim me ujë
JAVA 25	Ushtrime praktike: përdorimi i shkumës së lehtëdhe të rëndë
JAVA 26	Ushtrime praktike:vetëshpëtimi nga lartësitë,litarët dhe paisjet për vetshpëtim
JAVA 27	Përsëritja e temave të kaluara si dhe gadishmëria e plotë gjatë filjes së zjarreve
JAVA 37	Gjendje gadishmërie për intervenime fushore-malore
JAVA 37	Taktika zjarrfikëse:evakuimi i shtazëve dhe të mirave materiale
JAVA 38	Ushtrime praktike: shpëtimi nga lartësitë, përdorimi i lëshimores së hapur dhe të mbyllur

JAVA 39	Ushtrime praktike: shpëtimi nga lartësitë me përdorimin e litarit të kryqëzuar
JAVA 40	Specifikat e fikjes së zjarrit në kushte të ndërlikuara: mungesa e ujit, temperatura e ulta, era e fortë e tj.
JAVA 41	Furnizimi me ujë ,e lidhjen rendore-releje të pompave motorike zjarrifikëse
JAVA 42	Shpëtimi i personave të rrezikuar nga zjarri, fikja e zjarrit të improvizuar me mjete adekuate për fikjen e zjarrit si dhe paisjeve mbrojtëse
JAVA 43	Ushtriempaktike: fikja e zjarrit dhe shpëtimi i personave në fatkeqësi trafiku-improvizim
JAVA 44	Paisjet zjarrifikëse për intervenime teknike: përdorimi i gërrshërve didraulike për hapjen dhe demelimin e automjeteve dhe konstrukcioneve ndëtrimore
JAVA 45	Taktika zjarrifikëse: fikja e zjarreve në ndërtesa banimi, podrumi, kate, oxhage.
JAVA 46	Taktika zjarrifikëse: fikja e zjarreve në objekte publike, teatro, kino, spitale, muzeje, posta, banka spitale e tj.
JAVA 47	Taktika zjarrifikëse: fikja e zjarreve në objekte industriale, depo të ndryshme,rezervoare e tj.
JAVA 48	Taktika zjarrifikëse: fikja e zjarreve në mullinj, burimet e naftës, gazeve.
JAVA 49	Taktika zjarrifikëse: fikja e zjarreve në industrin kimike (njohja me materie të rrezikshme-ndezshme të cilat përdoren në procesin teknologjik në Korporatën Trepça.
JAVA 50	Fikja e zjarreve në male dhe taktika e fikjes.
JAVA 51	Fikja e zjarreve në mjetet e trafikut, transporti publik
JAVA 52	Testimi-verifikimi i njohurive profesionale zjarrifikëse.

Vërejtje: Plan-programi i trajnimit dhe ushtrimeve mund të ndërrohet sipas nevojës apo sipas planit për trajnim nga AME-se.